

AKTI THEMELIMIT I SHOQERISE "DEA ARREDIM" SH.P.K.

Kreu I

Themelimi, Emri, Objekti, Kohëzgjatja, Selia

Neni 1:

Data e Themelimit, Emri dhe Themeluesit

(1) Sot, më 23/02/2022, ne, themeluesit, kemi krijuar një shoqëri me përgjegjësi të kufizuar me emrin "DEA ARREDIM" SH.P.K.

(2) Themeluesit e shoqërisë janë :

Z. Ali Disha, qytetar Shqiptar, lindur ne Kukes, me 08.12.1981 me nr ID 034382251 dhe numer personal I11208030J, banues ne rrugen Pjeter Budi, Tirane, njeh dhe zoteron 1(nje) kuote te barabarte me 75% te kapitalit te pergjithshem te shoqerise me vlere 75 000 (shtatedhjetepesemije) leke

Znj. Marsela Koltraka, qytetare Shqiptar, lindur ne Bulqise, me 24.06.1984 me nr pasaporte BE1229656 dhe numer personal I45624071K, banues ne rrugen Andon Boshnjaku, Durres, njeh dhe zoteron 1(nje) kuote te barabarte me 25% te kapitalit te pergjithshem te shoqerise me vlere 25 000 (njezetepesemije) leke

Neni 2:

Objekti

Shoqëria do të kryejë aktivitetin e mëposhtëm:

2.1 Shoqëria ka për objekt zhvillimin dhe pjesëmarrjen në të gjitha aktivitetet që një shoqëri me përgjegjësi të kufizuar mund të zhvillojë sipas legjislacionit shqiptarë, por në mënyrë të vecantë:

- Tregëtim me shumicë dhe pakicë të mobiljeve, elementeve të drurit, imp-eks etj. Transport për të tretë. Riparim mobiljesh, lyerje mobiljesh, dhenie mobilje me qera. Eksport - Import të çdo makinerie apo pajisje që ka lidhje me prodhimin, si dhe çdo material tjetër të nevojshëm që lidhet me këto aktivitetet e lartë përmendura. Tregëtim dhe Transport i lëndës drusore, të papërpunuar dhe të përpunuar, si pishë, ah, lis etj si dhe druve të zjarrit. Tregëtim prodhimesh të ndryshme druri, mobilie, orëndi etj. Të merret me promovimin e shkëmbimeve tregtare nga Shqipëria për jashtë dhe nga jashtë për në Shqipëri. Tregëtimin e produkteve, me baze materiale të ndryshme, për të gjithë sektoret e ekonomisë. Tregëtim me shumicë e pakicë të artikujve tregtarë, konfeksione, tekstil për llogari të vet dhe për të tretë. Blerje pasuri të luajtshme apo të paluajtshme, t'i marrë ose t'i leshojë me qera, të marrë tenderin e tyre. Tregëtim artikujsh të ndryshëm ushqimorë, importeksport. Tregëtim pijesh alkoolike, me shumicë e pakicë, import-eksport. Tregëtim duhan cigare, me shumicë e pakicë, import-eksport. Tregëtim karburantesh të ndryshme, vajrash lubrifikante, të çdo tipi e lloji, me pakicë.
- Shoqëria mund të punësojë ose krijojë përfaqësi ose agjensi të ndërvarrura prej saj me ose pa llogari (bankare) me vetë.
- Shoqëria në mënyrë të pa parashikuar dhe të rastësishme për të realizuar interesat e saj mund të kryejë çdo lloj operacioni industrial, tregtar, financiar, në pasuri të tundshme ose të pa tundshme, duke përfshirë edhe kërkesën për kredi e financime duke dhënë garancitë e nevojshme në emer të shoqërisë.
- Shoqëria merr pjesë vetëm me qëllim të një investimi të qëndrueshëm pjesëmarrje të drejtperdrejt ose jo në shoqëri të tjera.
- Shoqëria do të zhvillojë aktivitete publiciteti, reklamash, marketing në të gjitha format dhe për të gjithë sektoret në të cilët do të veprojë dhe do të prodhojë.
- Shoqëria do të kryejë shërbime të ndryshme sponsorizimi.
- Shoqëria do të kryejë shërbime asistence pas shitje për produktet e shitura nga shoqëria dhe për të tretë.

2.2 Shoqëria mund të kryejë gjithashtu çdo lloj aktiviteti shtesë që rezultojnë në nevojshëm dhe i dobishëm për përbushjen e qëllimit kryesor ku mund të përfshihen tregëtimi i prodhimeve të tjera dhe kryerja e shërbimeve të tjera.

2.3 Me qëllim që të realizojë objektin e vetë me vendim të organit të vetë vendimmarres shoqëria mund të zotërojë drejtperdrejt ose jo aksione ose pjesëmarrje në shoqëri të tjerashqiptarë ose jashtë Shqipërie.

2.4 Shoqeria me vendim te organit te saj vendimmarres me qellim qe te arrije objektin e vete mund te marre pjese ne cdo lloj marreveshje tregtare, ne joint-venture(bashkpunim) me shoqeri te tjera si dhe te kryeje cdo lloj veprimi tjetër te nevojshem.

Shoqeria mund te firmose marreveshje vendodhje ,shitje-blerje, marreveshje per hipoteka, per pasuri te paluajtshme, marreveshje per hua ose financime, marreveshje per te ofruar sherbime si dhe cdo lloj marreveshje tjetër qe konsiderohet i nevojshem per vazhdimesine e realizimit te objektit te vete.

2.5 Per realizimin e qellimeve te paragrafeve, 2.1, 2.2, 2.3, 4.4 duhet aprovimi zyrtar i ortakeve

Neni 3:

Kohëzgjatja

Kohëzgjatja e shoqërisë do të jetë deri ne : **Pa caktuar.**

Neni 4:

Selia

(1) Selia e shoqërisë ndodhet ne adresën: Tirane Vore , Gjokaj, zona kadastrale 17/15, pasuria nr 40/63, km 12 Vore.

Kreu II

Kapitali

Neni 5

Kapitali themeltar

(1) Kapitali themeltar fillestar i shoqërisë është 100 000 (njeqindmije)Lekë . Pjesëmarrja e themeluesve në kapitalin e shoqërisë është në përputhje me kontributet e tyre të mëposhtme:

Z. Ali Disha, qytetar Shqiptar, lindur ne Kukës, me 08.12.1981 me nr ID 034382251 dhe numer personal I11208030J, banues ne rrugen Pjeter Budi, Tirane, njeh dhe zoteron 1(nje) kuote te barabarte me 75% te kapitalit te pergjithshem te shoqerise me vlere 75 000 (shtatedhjetepesemije) leke

Znj. Marsela Koltraka, qytetare Shqiptar, lindur ne Bulqise, me 24.06.1984 me nr pasaporte BE1229656 dhe numer personal I45624071K, banues ne rrugen Andon Boshnjaku, Durres, njeh dhe zoteron 1(nje) kuote te barabarte me 25% te kapitalit te pergjithshem te shoqerise me vlere 25 000 (njezetepesemije) leke

Kapitali I ortakeve mund te jete ne para ose ne natyre (pasuri te luajtshme/paluajtshme apo te drejta)

- Pergjegjesia e ortakeve per shoqerine dhe per te tretet (per detyrimet qe ka mare shoqeria) eshte e kufizuar ne pjesemarrjen respektive te tyre ne kapitalin e shoqerise.
- Kuotat jane te transferueshme de juro midis te gjalleve. Ky lloj transferimi kufizohet nga ushtrimi i te drejtes qe ortaket e tjere kane te drejten e parazgjedhjes ne propocion me kuotat e zoteruara dhe ne kondita te barabarta.
- Ne rast transferimesh te kuotes ne favor te biveve ose te afermeve te drejtperdrejte deri ne shkallen e dyte, te drejtat e permendura ne piken 5.3 nuk mund te ekzekutohen nga ortaket e tjere.
- Ortaku qe ka per qellim te shese pjeserisht ose krejt kuotat e veta duhet te informoje ortaket e tjere me nje leter rekomande ku te zyrtarizohet marja ne dorezim e letres, duke komunikuar cminin e kerkuar dhe menytrat e pageses. Brenda 30 diteve nga marja e letres ortaket duhet te bejne te vlefshme te drejten e tyre te parazgjedhjes (parablerjes). E drejta e parablerjes duhet te ushtrohet mbi te gjithë oferten per cmimin e kerkuar nga ofruesi. Ne raste se meshume se nje ortake kerkon te drejten e parazgjedhjes(parablerjes) kuota ne shitje do te blihet nga secili ortak ne perpjestim me kuoten qe zoteron ne kapitalin e pergjithshem. Heqja dore nga e drejta e parablerjes ose mos kthimi i pergjigjes per parablerje brenda 30 diteve i lejon ortakut qe deshiron te shese, te shese kuoten e vete ne menyre te libre brenda 30 diteve pas skadimit te afatit.



Neni 6:

Zmadhimi dhe zvogelimi i kapitalit

Kapitali i shoqërisë mund të zmadhohet nepermjet nënshkrimeve të pjesëve të kapitalit themeltar për kontributet në para dhe me anë të kontributeve në natyrë, nepermjet emerimit nga gjykata kompetente e nje eksperti te autorizuar per keto kontribute sipas kërkesës së administratorit.

Në asnjë rast shumica nuk mund të detyrojë një ortak për të rritur angazhimin e tij në kapitalin themeltar të shoqërisë.

Zvogëlimi i kapitalit lejohet nga asambleja e ortakëve, e cila merr vendim në të njëjtat kushte që kërkohen për ndryshimin e statutit.

Në të gjitha rastet zvogëlimi i prek ortakët në të njëjtën masë ndaj pjesëve të kapitalit që përfaqësojnë.

Cdo ortak kate drejte te zoteroje nje certificate qa verteton kuoten e tij te pjesemarrjes. Shoqeria nuk eshte e detyruar te emetoje me shume se nje certificate per kuotat e mbajtura nga me shume se nje ortak se bashku dhe dorezimi i certifikates perfaqesuesit te perbashket te ortakeve do te konsiderohet si e kryer ne favor te te gjithë ortakeve sipas ligjeve ne fuqi. Emrat e ortakeve qe zoterojne nje kuote pjesemarrje tregohen ne certifikaten e pjesemarrjes.

Neni 7

Transferimi i kapitalit

Kuotat e kapitalit të një shoqërie me përgjegjësi të kufizuar e të drejtat që rrjedhin prej tyre mund të fitohen apo kalohen nëpërmjet:

- a) kontributit në kapitalin e shoqërisë;
- b) shitblerjes;
- c) trashëgimisë;
- ç) dhurimit;
- d) çdo mënyre tjetër të parashikuar me ligj.

Pjesët e kapitalit themeltar janë lirisht të transferueshme ndërmjet ortakëve, për sa nuk parashikohet ndryshe ne statut.

Pjesët e kapitalit themeltar janë lirisht të transferueshme me rrugë trashëgimie si me poshte:

7.1 Kuota e pjesemarrjes jane lirisht te transferueshme per shkak te vdekjes tek trashigimtarët. Neqoftese ortaku i vdekur ka me shume se nje trashegimtar, vete trashegimtarët duhet te emerojne nje perfaqesues te perbashket.

7.2 Personi qe kate drejte mbi kuoten e pjesemarrjes per shkak te vdekjes ose falimentimit te ortakut mund te preferoje te behet titullar i kuotes perkatese te pjesemarrjes nepermjet te nje lajmerimi zyrtar me shkrim brenda 15 diteve, duhet tia dergoje shoqërisë ose te kerkoje rregjistrimin e te treteve te autorizuar prej tij si titullar te kuotes si pjesemarrës.

7.3 Personi qe behet titullar i kuotes pjesemarrjes pas vdekjes ose falimentimit tenje ortaku mund te gezoje te njejtat te drejta qe kishte ortaku i vdekur ose i falimentuar mbi kuoten e vete.

7.4 Ne asnje rast zgjedhja e titullarit te kuotes se ortakut te vdekur ose falimentuar nuk mund te ndaloje aktivitetin prodhues, tregtar dhe administrative te shoqërisë.

KREU III

ORGANET VENDIMMARRESE DHE DREJTUESE

Neni 8


Organi Vendimmarres

Asambleja e Ortakëve është organi i vetem vendimmarres i shoqërisë.

Asambleja e Ortakëve është organi i vetem vendimmarres i shoqërisë qe miraton cdo ndryshim te statutit sipas modaliteteve te percaktuara ne ligj.

Asambleja e përgjithshme e ortakëve është përgjegjëse për marrjen e vendimeve për shoqërinë për çështjet e mëposhtme:

- a) përcaktimin e politikave tregtare të shoqërisë;
- b) ndryshimet e statutit;



- c) emërimin e shkarkimin e administratorëve;
- ç) emërimin e shkarkimin i likuiduesve dhe të ekspertëve kontabël të autorizuar;
- d) përcaktimin e shpërblimeve për personat e përmendur në shkronjat "c" dhe "ç" të kësaj pike;
- dh) mbikëqyrjen e zbatimit të politikave tregtare nga administratorët, përfshirë përgatitjen e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecurisë së veprimtarisë;
- e) miratimin e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecurisë së veprimtarisë;
- ë) zmadhimin dhe zvogëlimin e kapitalit;
- f) pjesëtimin e kuotave dhe anulimin e tyre;
- g) përfaqësimin e shoqërisë në gjykatë dhe në procedimet e tjera ndaj administratorëve;
- gj) riorganizimin dhe prishjen e shoqërisë;
- h) miratimin e rregullave procedurale të mbledhjeve të asamblesë;
- i) çështje të tjera të parashikuara nga ligji apo statuti.

Ortaku mund të përfaqësohet në asamblenë e përgjithshme, në bazë të një autorizimi nga një ortak tjetër apo nga një person i tretë.

Administratori i shoqërisë nuk mund të veprojnë si përfaqësues i ortakëve në asamblenë e përgjithshme.

Autorizimi mund të jepet vetëm për një mbledhje të asamblesë së përgjithshme, e cila përfshin edhe mbledhjet vijuese me të njëjtin rend dite.

- Organi administrative i shoqërisë me qëllim që të sigurojë vazhdueshmerinë e objektit të shoqërisë mund të kërkojë financime nga të tretët, financime të metejshme nga ortakët (qofte edhe të ndryshëm nga ai i kërkuar për rritjen e kapitalit të shoqërisë).

- Financimet e ortakëve do të jepen vetëm kundrejt pageses së interesave ose mund të jenë pa interes. Kjo do të bazohet në atë për të cilin financimi do të jepet.

- Çdo operacion financiar sikurse operacionet e tjera financiare duhet paraprakisht të shqyrtohet dhe aprovohet nga Asambleja e Ortakëve.

Neni 9

Mënyra e thirrjes së mbledhjes së Asamblesë së Përgjithshme

Asambleja e përgjithshme thirret nëpërmjet një njoftimi me shkresë ose, nëse parashikohet nga statuti, me njoftim nëpërmjet postës elektronike. Njoftimi me shkresë apo me mesazh elektronik duhet të përmbajë vendin, datën, orën e mbledhjes dhe rendin e ditës e t'u dërgohet të gjithë ortakëve, jo më vonë se 7 ditë përpara datës së parashikuar për mbledhjen e asamblesë.

Kur asambleja e përgjithshme nuk është thirrur sipas pikës 1 të këtij neni, ajo mund të marrë vendime të vlefshme vetëm nëse të gjithë ortakët janë dakord, për të marrë vendime, pavarësisht parregullsisë.

Neni 10

Kuorumi

Në rastin e marrjes së vendimeve, që kërkojnë një shumicë të zakonshme, asambleja e përgjithshme mund të marrë vendime të vlefshme vetëm nëse marrin pjesë ortakët me të drejtë vote, që zotërojnë më shumë se 30 për qind të kuotave.

Në rastin kur asambleja e përgjithshme duhet të vendosë për çështje, të cilat kërkojnë shumicë të kualifikuar sipas nenit 87 të ligjit "Per Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare", ajo mund të marrë vendime të vlefshme vetëm, nëse ortakët që zotërojnë më shumë se gjysmën e numrit total të votave, janë të pranishëm personalisht, votojnë me shkresë, apo mjete elektronike, sipas parashikimeve të pikës 3 të nenit 88 të këtij ligji.

Nëse asambleja e përgjithshme nuk mund të mbledhet për shkak të mungesës së kuorumit të përmendur më lart, asambleja mbledhet përsëri jo më vonë se 30 ditë, me të njëjtin rend dite.

Neni 11

Marrja e vendimeve

Asambleja e përgjithshme vendos me tri të katërtat e votave të zotëruesve të kapitalit, të ortakëve pjesëmarrës, për ndryshimin e statutit, zmadhimin ose zvogëlimin e kapitalit të regjistruar, shpërndarjen e fitimeve, riorganizimin dhe prishjen e shoqërisë.

Asambleja e përgjithshme vendos me shumicën e votave të ortakëve pjesëmarrës, për çështje të tjera si :

- a) përcaktimi i politikave tregtare të shoqërisë;
- b) emërimin dhe shkarkimin e administratorëve;
- c) emërimin e shkarkimin i likuiduesve dhe të ekspertëve kontabël të autorizuar;
- ç) përcaktimin e shpërblimeve

- d) mbikëqyrjen e zbatimit të politikave tregtare nga administratorët, përfshirë përgatitjen e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecurisë së veprimtarisë;
- e) përfaqësimin e shoqërisë në gjykatë dhe në procedimet e tjera ndaj administratorëve;
- f) miratimin e rregullave procedurale të mbledhjeve të asamblesë;
- Cdo ndryshim statuti duhet të depozitohet pranë QKR për të pasyqruar ndryshimet në skeden e shoqërisë.

- Në mbyllje të cdo viti financiar administratori kryen të gjithë veprimet e nevojshme për përgatitjen e bilancit vjetor, të dokumentave kontabel që janë subjek i shqyrtimit dhe aprovimit nga asambleja e ortakeve. Asambleja e ortakeve aprovon bilancin ushtrimor ose kërkon nga administrator të kryejë ndryshimet e nevojshme Brenda kufive të ligjeve që parashikojnë.
- Asambleja e Ortakeve vendos lidhur me shpërndarjen e të ardhurave neto (dividenti) që rezultojnë nga bilanci i vitit ushtrimor të aprovuar. Shuma e të ardhurave neto që do të shpërndahet do të përcaktohet në bazë të bilancit ushtrimor vjetor, pasi shoqëria ka kryer kompensimin e humbjeve eventuale.

Neni 12

Përjashtimi nga e drejta e votës

1. Ortaku nuk mund të ushtrojë të drejtën e votës nëse asambleja e përgjithshme merr vendim për:

- a) vlerësimin e veprimtarisë së tij;
- b) shuarjen e ndonjë detyrimi në ngarkim të tij;
- c) ngritjen e një padie ndaj tij nga shoqëria;
- ç) dhënien ose jo të përfitimeve të reja.

2. Kur ortaku përfaqësohet nga një përfaqësues i autorizuar, i autorizuari vlerësohet të jetë në të njëjtin konflikt interesi, ashtu si dhe ortaku, të cilin përfaqëson.

Neni 13

Administrimi

(1) Asambleja e përgjithshme emëron një ose më shumë persona fizikë si administratorë të shoqërisë. Afati i emërimit, është 5 vjet, me të drejtë ripërtëritjeje. Emërimi i administratorëve prodhon efekte pas regjistrimit në Qendrën Kombëtare të Regjistrimit.

(2) Administratorët e një shoqërie tregtare mëmë, sipas përcaktimit të nenit 207 të këtij ligji, nuk mund të emërohen si administratorë të një shoqërie të kontrolluar e anasjelltas. Çdo emërim i bërë në kundërshtim me këto dispozita është i pavlefshëm.

(3) Personat e mëposhtëm caktohen si Administratorë të parë të shoqërisë deri në emërimin e tyre nga mbledhja e parë e Asamblesë së Përgjithshme.

- **Znj. Marsela Koltraka**

Shpërblimi Administratorit përcaktohet nga Asambleja e Ortakeve në mbledhjen e parë të zakonshme.

Neni 14

Kompetencat e Administratorëve

Administratorët kanë të drejtë e detyrohen të:

- a) kryejnë të gjitha veprimet e administrimit të veprimtarisë tregtare të shoqërisë, duke zbatuar politikën tregtare, të vendosura nga asambleja e përgjithshme;
- b) përfaqësojnë shoqërinë tregtare;
- c) kujdesen për mbajtjen e saktë e të rregullt të dokumenteve dhe të librave kontabel të shoqërisë;
- ç) përgatisin dhe nënshkruajnë bilancin vjetor, bilancin e konsoliduar dhe raportin e ecurisë së veprimtarisë dhe, së bashku me propozimet për shpërndarjen e fitimeve, i paraqesin këto dokumente përpara asamblesë së përgjithshme për miratim;
- d) krijojnë një sistem paralajmërimi në kohën e duhur për rrethanat, që kërcënojnë mbarëvajtjen e veprimtarisë dhe ekzistencën e shoqërisë;
- dh) kryejnë regjistrimet dhe dërgojnë të dhënat e detyrueshme të shoqërisë, siç parashikohet në ligjin për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit;

e) raportojnë përpara asamblesë së përgjithshme në lidhje me zbatimin e politikave tregtare dhe me realizimin e veprimeve të posaçme me rëndësi të veçantë për veprimtarinë e shoqërisë tregtare;

ë) kryejnë detyra të tjera të përcaktuara në ligj dhe në statut.

Administratoret janë të detyruar të therasin Asamblenë e Përgjithshme, në rastet kur:

-sipas bilancit vjetor apo raporteve të ndërmjetme financiare, rezultojnë ose ekziston rreziku që aktivet e shoqërisë nuk i mbulojnë detyrimet e kërkueshme brenda 3 muajve në vazhdim.

-shoqëria propozon të shesë apo të disponojë në mënyrë tjetër aktive, të cilat kanë një vlerë më të lartë se 5 për qind të aseteve të shoqërisë, që rezultojnë në pasqyrat e fundit financiare të certifikuara.

Asambleja e përgjithshme mund të shkarkojë administratorin në çdo kohë me shumicë të zakonshme. Padi të, që lidhen me shpërblimin e administratorit, në bazë të marrëdhënieve kontraktore me shoqërinë, rregullohen sipas dispozitave ligjore në fuqi.

Neni 15

Pergjegjesite e Administratorit

Administratori është përgjegjës individualisht, ndaj shoqërisë ose ndaj të tretëve, për shkelje të ligjeve, për shkelje të statutit, apo për gabime të kryera gjatë administrimit të shoqërisë.

Përveç sa është parashikuar në dispozitat e përgjithshme të detyrimit të besnikërisë, sipas neneve 14, 15, 17 e 18 të ligjit "Per Tregtaret dhe Shoqerite Tregtare", administratori detyrohet:

1. a) të kryejë detyrat e tij të përcaktuara në ligj dhe në statut në mirëbesim e në interesin më të mirë të shoqërisë në tërësi, duke i kushtuar vëmendje të veçantë ndikimit të veprimtarisë së shoqërisë në mjedis;

b) të ushtrojë kompetencat që i njihen në ligj dhe në statut vetëm për arritjen e qëllimeve të përcaktuara në këto dispozita;

c) të vlerësojë me përgjegjësi çështjet, për të cilat merret vendim;

ç) të parandalojë dhe mënjanojë rastet e konfliktit, prezent apo të mundshëm, të interesave personalë me ata të shoqërisë;

d) të ushtrojë detyrat e tij me profesionalizmin dhe kujdesin e nevojshëm.

2. Administratori, gjatë kryerjes së detyrave të tij, përgjigjen ndaj shoqërisë për çdo veprim ose mosveprim, që lidhet në mënyrë të arsyeshme me qëllimet e shoqërisë tregtare, me përjashtim të rasteve kur, në bazë të hetimit dhe vlerësimit të informacioneve përkatëse, veprimi ose mosveprimi është kryer në mirëbesim.

3. Nëse administratori vepron në kundërshtim me detyrat dhe shkel standardet profesionale, sipas pikave 1 e 2 të këtij neni, është i detyruar t'i dëmshpërblejë shoqërisë dëmet, që rrjedhin nga kryerja e shkeljes, si dhe t'i kalojë çdo fitim personal që ata apo personat e lidhur me ta kanë realizuar nga këto veprime të parregullta. Administratori ka barrën e provës për të vërtetuar kryerjen e detyrave të tyre në mënyrë të rregullt e sipas standardeve të kërkuara. Kur shkelja është kryer nga më shumë se një administrator, ata përgjigjen ndaj shoqërisë në mënyrë solidarë.

4. Në mënyrë të veçantë, por pa u kufizuar në to, administratori është i detyruar t'i dëmshpërblejë shoqërisë dëmet e shkaktuara, nëse, në kundërshtim me dispozitat e ligjit „ Per Tregtaret dhe Shoqerite Tregtare , kryen veprimet e mëposhtme:

a) u kthen ortakëve kontributet;

b) u paguan ortakëve interesa apo dividendë;

c) u shpërndan aktivet shoqërisë;

ç) lejon që shoqëria të vazhdojë veprimtarinë tregtare, kur, në bazë të gjendjes financiare, duhej të parashikohej që shoqëria nuk do të kishte aftësi paguese për të shlyer detyrimet;

d) jep kredi.

Përveç padisë për shlyerjen e dëmit që i ngarkohet personalisht administratorit, ortakët individualisht ose se bashku, kanë të drejtë të ngrenë padi penale kundër administratorit

Paditësit kanë të drejtë të ndjekin në rrugë ligjore shlyerjen e plotë të dëmit që i është shkaktuar shoqërisë, përfshirë edhe dëmshpërblimin financiar, nëse është e nevojshme. Asnjë vendim i asamblesë nuk mund të ndalojë ngritjen e kërkesë padisë kundër administratorit për gabimet e kryera prej tij gjatë ushtrimit të detyrës.


Kreu IV

Viti financiar-ekspertet

Neni 16

Viti Financiar

Viti financiar i Shoqerise fillon me 1 Janar dhe perfundon me 31 Dhjetor. Përfundimisht, viti i pare financiar fillon nga data e regjistrimit te shoqerise ne Qendren Kombetare te Regjistrimit dhe mbyllet me 31 Dhjetor.



Neni 17

Ekspertet

Kontrolli financiar i shoqërisë kryhet nga Eksperti Kontabel i Autorizuar sipas legjislacionit shqiptar ne fuqi. Asambleja e ortakeve emeron nje Ekspert Kontabel te Autorizuar ne te gjitha rastet e nevojshme por edhe ne ato raste ne te cilat nje emrim i tille eshte i detyrueshem nga ligjet shqiptare.

- Mbjajta e librave te shoqërisë dhe te rregjistrave te kontabilitetit te shoqërisë do te kryhet ne respekt te normave te parashikuara ne kodin civil, kodi fiskal dhe ne kete statut.

- Ne cdo moment secili nga ortaket ka te drejten te kerkoje dhe te marre nje informacion komplet per aktivitetin dhe kontabilitetin e shoqërisë, gjithashtu cdo ortak kate drejten te kontrolloje me shpenzimet e vetate gjithe rregjistrat dhe dokumentat kontabel te shoqërisë, dhe te kryeje me shpenzimet e veta nje revision kontabel dhe administrative te shoqërisë.

- Pergjegjesia civile, fiskale dhe penale lidhur me rregullsine e kontabiliteteve fiskale te shoqërisë eshte ne ngarkim te administratorit te vetem te shoqërisë.

Eksperti ka per detyre qe te kontrolloje te gjithe dokumentacionin kontabel te veprimtarise ekonomiko tregtare te shoqërisë, ate gjithëvjetor dhe ate ne lidhje me kontrolltet periodike te ushtruara prej tij per rastet kur ai eshte ngarkuar dhe ka kryer nje gje te tille i ngarkuar nga ana e ortakeve.

Ne perfundim te kontrollit eksperti kontabel i autorizuar pergatit raportin me shkrim per nxjerrjen e rezultatit te bilancit financiar vjetor si dhe per ate per kontrolltet periodike te ushtruara, te cilat eshte i detyruar qe t'ja paraqese e dorezoje ne kohe ortakeve per t'i shqyrtuar e miratuar mbi bazen e te drejtes vendimore qe ka.

Kreu V

Prishja –riorganizimi i shoqërisë

Neni 18

Prishja dhe likuidimi

Shperndarja ose prishja e shoqërisë mund te behet ne cdo kohe :

- a) kur mbaron kohëzgjatja e parashikuar në themelimin e saj;
- b) me vendim të Asamblese se Ortakeve;
- c) me hapjen e procedurave të falimentimit;
- ç) nëse nuk ka kryer veprimtari tregtare për dy vjet dhe nuk është njoftuar pezullimi i veprimtarisë në përputhje me pikën 3 të nenit 43 të ligjit nr.9723, datë 3.5.2007 “Për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit”;
- d) me vendim të gjykatës;

Ne kete rast Ortaket merrin vendim me shkrim ne te cilin parashikojne menyren e likuidimit të shoqërisë, duke caktuar 1 apo disa likuidatore dhe shenuar ne cdo dokument të nxjerre prej tij emrin e likuidatorit dhe emertesën shtese “ Shoqeri ne likuidim e siper “.

Prishja e shoqërive tregtare ka si pasojë hapjen e procedurave të likuidimit në gjendjen e aftësisë paguese, me përjashtim të rasteve kur është nisur një procedurë falimentimi.

Likuidimi kryhet nga likuiduesit e emëruar nga Ortaket.

Nëse Ortaket nuk merrin një vendim për emërimin e likuiduesve, brenda 30 ditëve pas prishjes, çdo person i interesuar mund t'i drejtohet gjykatës, për të caktuar një likuidues.

Neni 19

Riorganizimi i shoqërisë bashkimi-ndarja


Shoqëria mund të ndahet, bashkohet sipas Vendimit të Mbledhjes së Përgjithshme të Asamblesë së Ortakëve, në përputhje me dispozitat ligjore të parashikuara në Pjesën IX të Ligjit 9901 datë 14.04.2012 “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare.”

Neni 20

Baza Ligjore

Shoqëria do te zhvilloje aktivitetin e tij ne perputhje te plote me kete statut dhe dispozitat e legjislacionit shqiptar.

Per sa nuk parashikohet ne kete statut, do te zbatohen dispozitat e ligjit "Per tregtarët dhe shoqërite tregtare", Kodit Civil dhe çfaredo ligji tjetër specifik ne Republikën e Shqipërisë.



Neni 21


Mosmarrëveshjet

Per mosmarrëveshjet qe mund te lindin ne lidhje me zbatimin apo interpretimin e ketij statuti, si dhe per çdo mosmarrëveshje qe mund te linde midis Shoqerise dhe te treteve, do te jete kompetente Gjykata Shqiptar.

Ortaku autorizon z. **Znj. Marsela Koltraka**, qytetare Shqiptar, lindur ne Bulqise, me 24.06.1984 me nr pasaporte BE1229656 dhe numer personal I45624071K, te kryeje veprimet prane QKR-se per per regjistrimin e shoqerise "DEA ARREDIM" shpk.

ASAMBLEJA ORTAKEVE
I SHOQËRISE ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUAR
"DEA ARREDIM" SH.P.K

Z. Ali DISHA



Znj. Marsela KOLTRAKA

